

KIRFN Interpretimi 18 *Transferimi i Aktiveve nga Klientët*

Referencat

- *Kuadri për Përgatitjen dhe Paraqitjen e Pasqyrave Financiare*
- SNRF 1 *Zbatimi për herë të parë i standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar* (rishikuar në 2008)
- SNK 8 *Politikat Kontabël, Ndryshimet në Vlerësimet Kontabël dhe Gabimet*
- SNK 16 *Aktivet Afatgjata Materiale*
- SNK 18 *Të ardhurat*
- SNK 20 *Kontabiliteti për Grantet Qeveritare dhe Paraqitja e Informacionit Shtesë për Ndhimën Qeveritare*
- KIFRN 12 *Marrëveshjet Konçensionare të shërbimit*

Historiku

- 1 Në industrinë e shërbimeve, një njësi ekonomike mund të marrë prej klientëve të vet elementë të aktiveve afatgjata materiale të cilat duhet të përdoren për të lidhur këta klientë me një rrjet dhe për t'u siguruar atyre një furnizim të vazhdueshëm me të mirat si p.sh. energjinë elektrike, gaz ose ujë. Mundet gjithashtu që një njësi ekonomike të marrë mjete monetare nga klientët e vet për të blerë ose për të ndërtuar elementë të tillë të aktiveve afatgjata materiale. Zakonisht klientëve u kërkohet që të paguajnë shuma shtesë për blerjen e mallrave, produkteve ose shërbimeve bazuar në përdorim.
- 2 Transferimi i aktiveve nga klientët mund të ndodhë edhe në industri të tjera përveç industrisë së shërbimeve. Për shembull një njësi ekonomike që siguron nga të tretët jshtë saj funksionin e teknologjisë së informacionit mund të transferojë elementë të vet të aktiveve afatgjata materiale tek ofruesi i jashtëm i shërbimit.
- 3 Në disa raste ai që transferon aktivin mund të mos jetë njësi ekonomike që do të përfitojë furnizimin e vazhdueshëm me mallrat, produktet ose shërbimet. Megjithatë për thjeshtësi në këtë Interpretim njësisë ekonomike që transferon aktivin i referohemi si klienti.

Objekti

- 4 Ky Interpretim zbatohet për trajtimin kontabël të tranferimit të elementëve të aktiveve afatgjata materiale nga njësitë ekonomike që marrin tranferime të tilla nga klientët e tyre.
- 5 Objekt i këtij Interpretimi janë marrëveshjet në të cilat një njësi ekonomike merr nga një klient një element të aktiveve afatgjata materiale, të cilin njësi duhet ta përdorë ose për të lidhur klientin me një rrjet ose për t'i siguruar klientit furnizim të vazhdueshëm me mallra, produkte ose shërbime ose për të dyja bashkë.
- 6 Ky Interpretim zbatohet edhe për marrëveshjet në të cilat një njësi ekonomike merr mjete monetare nga klienti të cilat duhet të përdoren vetëm për të ndërtuar ose blerë elementë të aktiveve afatgjata materiale. Njësi ekonomike duhet të përdorë më pas këto elementë (aktive afatgjata materiale) ose për të lidhur klientin me një rrjet ose për t'i

siguruar klientit furnizim të vazhdueshëm me mallra, produkte ose shërbime ose për të dyja bashkë.

- 7 Ky Interpretim nuk zbatohet për marrëveshje në të cilat transferimi lidhet me një grant qeveritar sipas përcaktimit në SNK 20 ose infrastrukturë që përdoret në marrëveshjet e dhënies me konçesion objekt i KIRFN 12.

Çështjet

- 8 Interpretimi trajton probleme në vijim:
- (a) A plotësohet përkufizimi i një aktivi?
 - (b) Nëse plotësohet përkufizimi i aktivitetit, si duhet të matet në hyrje elementi transferuar i aktiveve afatgjata materiale??
 - (c) Nëse elementi i aktiveve afatgjata materiale në hyrje matet me vlerën e drejtë si duhet të trajtohet kredia e mbetur?
 - (d) Si duhet të trajtojë në kontabilitet njësi ekonomike transferimet në mjete monetare nga klientët e vet?

Konsensusi

A plotësohet përkufizimi i një aktivi?

- 9 Nëse një njësi ekonomike merr nga një klient një transferim në elementë të aktiveve afatgjata materiale, duhet të vlerësojë nëse elementi i transferuar plotëson përkufizimin e një aktivi sipas përcaktimit të dhënë në *Kuadër*. Paragrafi 49(a) i *Kuadrit* përcakton se ‘një aktiv është një burim i kontrolluar nga njësi ekonomike si pasojë e ngjarjeve të shkuara dhe prej të cilit njësi ekonomike pret të marrë përfitime ekonomike të ardhshme.’ Në shumicën e rasteve njësi ekonomike merr të drejtën e pronësisë të elementit të transferuar të aktiveve afatgjata materiale. Megjithatë e drejta e pronësisë nuk është thelbësore në përcaktimin e ekzistencës së aktivitetit. Prandaj nëse klienti vazhdon të kontrollojë elementin e transferuar përkufizimi i aktivitetit nuk plotësohet edhe pse është transferuar pronësia.
- 10 Një njësi ekonomike që kontrollon një aktiv, zakonisht mund t’a trajtojë atë aktiv sipas dëshirës. Për shembull njësi ekonomike mund të këmbejë aktivin me aktive të tjera, mund t’a përdorë për të prodhuar të mira ose shërbime, mund t’a japë në përdorim kundrejt një çmimi, mund t’a përdorë për të shlyer detyrime ose ta shpërndajë tek pronarët. Njësi ekonomike që merr nga një klient si transferim një element të aktiveve afatgjata materiale kur vlerëson kontrollin mbi elementin e transferuar duhet të marrë në konsideratë të gjitha faktet dhe rrethanat përkatëse. Për shembull megjithëse njësi ekonomike duhet të përdorë elementin e transferuar të aktiveve afatgjata materiale për të siguruar një ose më shumë shërbime për klientin, mund të ketë dhe mundësinë për të vendosur sesi të përdoret, mirëmbahet dhe kur duhet të zëvendësohet elementi i transferuar i aktiveve afatgjata materiale. Në këtë rast njësi ekonomike mund të arrijë në përfundimin se kontrollon elementin e transferuar të aktiveve afatgjata materiale.

Si duhet të matet në hyrje elementi i transferuar i aktiveve afatgjata materiale?

- 11 Nëse njësia ekonomike arrin në përfundimin se plotësohet përkufizimi i aktivitetit, duhet të njohë aktivitetin e transferuar si një zë të grupimit të aktiveve afatgjata materiale në përputhje me paragrafin 7 të SNK 16 dhe t'a njohë në hyrje me vlerën e drejtë të tij në përputhje me paragrafin 24 të këtij Standardi.

Si duhet të trajtohet kreditimi në kontabilitet?

- 12 Në komentet në vijim supozohet se njësia ekonomike që merr një element të aktiveve afatgjata materiale ka dalë në përfundimin se zëri i transferuar duhet të njihet në përputhje me paragrafët 9–11.
- 13 Paragrafi 12 SNK 18 përcakton se 'Kur mallrat, produktet shiten ose shërbimet kryhen në këmbim të mallrave, produkteve ose shërbimeve jo të ngjashme, këmbimi trajtohet si një transaksion që krijon të ardhura.' Sipas kushteve të marrëveshjes objekt i këtij Interpretimi, transferimi i një elementi të aktiveve afatgjata materiale do të jetë këmbim për mallra, produkte ose shërbime jo të ngjashme. Për pasojë njësia ekonomike duhet të njohë të ardhurat e krijuara në përputhje me SNK 18.

Identifikimi i shërbimeve të identifikueshme veçmas

- 14 Një njësi ekonomike mund të bjerë dakord të lëvrojë një ose më shumë shërbime në këmbim të elementit të transferuar të aktiveve afatgjata materiale, të tillë si lidhja e klientit me një rrjet, ofrimi i furnizimit të vazhdueshëm me të mira ose shërbime klientit ose të dyja bashkë. Në përputhje me paragrafin 13 SNK 18, njësia ekonomike duhet të identifikojë veçmas shërbimet e identifikueshme të përfshira në marrëveshje.
- 15 Veçoritë që tregojnë se lidhja e klientit me një rrjet është një shërbim i identifikueshëm veçmas përfshijnë sa vijon:
- (a) shërbimi i lidhjes në rrjet është lëvruar tek klienti dhe përfaqëson një vlerë të përcaktuar për këtë klient;
 - (b) vlera e drejtë e shërbimit të lidhjes mund të matet në mënyrë të besueshme.
- 16 Një veçori që tregon se ofrimi i një shërbimi të vazhdueshëm për të mira ose shërbime klientit është një shërbim i identifikueshëm veçmas, është se në të ardhmen klienti që bën transferimin merr furnizim të vazhdueshëm në mallra, produkte ose shërbime ose të dyja bashkë me një çmim më të ulët sesa do të ishte pa transferimin e elementit të aktiveve afatgjata materiale.
- 17 Nga ana tjetër një veçori që tregon se detyrimi për t'i siguruar klientit furnizim të vazhdueshëm me mallra, produkte ose shërbime lind nga kushtet e licencës së veprimtarisë së njësisë ekonomike ose rregullime të tjera të ndryshme nga marrëveshja e transferimit të një elementi të aktiveve afatgjata materiale, është se klienti që bën transferimin paguan të njëjtin çmim si të tjerët që nuk transferojnë aktive për furnizim të vazhdueshëm me mallra, produkte ose shërbime, ose për të dyja bashkë.

Njohja e të ardhurave

- 18 Nëse identifikohet vetëm një shërbim, njësia ekonomike duhet të njohë të ardhurat kur të jetë kryer shërbimi në përputhje me paragrafin 20 të SNK 18.

- 19 Nëse identifikohen më shumë se një shërbim i identifikueshëm veçmas, paragrafi 13 i SNK 18 kërkon që vlera e drejtë gjithsej e konsideratës së marrë ose për t'u marrë nga marrëveshja të shpërndahet për secilin shërbim dhe të zbatohen kriteret e njohjes sipas SNK 18 për secilin shërbim.
- 20 Nëse një shërbim i vazhdueshëm identifikohet si pjesë e një marrëveshjeje, zakonisht periudha gjatë së cilës do të njihen të ardhurat përcaktohet nga kushtet e marrëveshjes me klientin. Nëse marrëveshja nuk cilëson periudhën, të ardhurat do të njihen përgjatë një periudhe jo më të gjatë se jeta e dobishme e aktivitetit të transferuar të përdorur për të siguruar shërbimin e vazhdueshëm.

Si duhet të trajtohet në kontabilitetin e njësisë ekonomike një transferim në mjete monetare nga klienti i saj?

- 21 Nëse njësisia ekonomike merr një transferim në mjete monetare nga një klient i vet duhet të vlerësojë nëse marrëveshja është objekt i këtij Interpretimi në përputhje me paragrafin 6. Nëse po, njësisia ekonomike duhet të vlerësojë nëse elementi i ndërtuar ose i blerë i aktiveve afatgjata materiale plotëson përkufizimin e një aktiviteti në përputhje me paragrafët 9 dhe 10. Nëse plotësohet përkufizimi i një aktiviteti, njësisia ekonomike duhet të njohë elementin e aktiveve afatgjata materiale me kosto në përputhje me SNK 16 dhe duhet të njohë në të ardhurat shumën e mjeteve monetare të marrë nga klienti në përputhje me paragrafët 13–20.

Data e hyrjes në fuqi dhe dispozita kalimtare

- 22 Një njësi ekonomike duhet të zbatojë këtë Interpretim në mënyrë prospektive për transferimin e aktiveve të marra nga klientët më 1 Korrik 2009 ose më pas. Lejohet zbatimi më herët nëse është marrë vlerësimi dhe informacion tjetër i nevojshëm për të zbatuar Interpretimin për transferimet e shkuara në kohën kur kanë ndodhur transferimet. Një njësi ekonomike duhet të paraqesë në shënimet shpjeguese datën kur është zbatuar Interpretimi.

Shtojca

Ndryshime në SNRF 1 Zbatimi për herë të parë i Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (rishikuar në 2008)

- A1 Në Shtojcën D paragrafi D1 është ndryshuar si vijon.
- D1 Një njësi ekonomike mund të zgjedhë të përdorë një ose më shumë nga përjashtimet në vijim:
- (a) transaksionet e pagesave të bazuara në aksione (paragrafët D2 dhe D3);
 - (m) aktivet financiare ose aktivet afatgjata jomateriale të trajtuara në përputhje me KIRFN 12 *Marrëveshjet e Konçesioneve të Shërbimeve* (paragrafi D22);
 - (n) kostot e huamarrjes (paragrafi D23); dhe
 - (o) transferimet e aktiveve nga klientët (paragrafi D24).
- A2 Pas paragrafit D23 janë shtuar një titull dhe paragrafi D24.

Transferimi i aktiveve nga klientët

- D24 Një zbatues për herë të parë mund të zbatojë dispozitat kalimtare të paraqitura në paragrafin 22 të KIFRN 18 *Transferrimi i Aktiveve nga Klientët*. Ky paragrafi përcakton si datë të hyrjes në fuqi 1 Korrik 2009 ose datën e përdorimit të SNRF-ve, cilado që të jetë më vonë. Gjithashtu një zbatues për herë të parë mund të vendosë të përdorë çdo datë para përdorimit të SNRF-ve dhe të zbatojë KIFRN 18 për të gjitha transferimet e aktiveve të marra nga klientët në këtë datë ose më pas.